

Vendim nr. 80 datë 13.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 13.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (F) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **FATJON REXHO**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022- 1384 (265), datë 18.10.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 29, 34, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 7 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 49 dhe 71 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Ndaj kërkuesit Fatjon Rexho dhe shtetasve A.C. e F.P., Prokuroria pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Vlorë ka regjistruar procedimin penal nr. 1187/2015 për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal (KP). Në përfundim të hetimeve organi i prokurorisë ka kërkuar gjykimin e tyre për këtë akuzë.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 492, datë 20.07.2016, ka vendosur: *“[...] Deklarimin fajtor të të pandehurit Fatjon Rexho për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, dhe në bazë të nenit 283/2 të Kodit Penal e dënon me 7 (shtatë) vjet burgim. Në bazë të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale urdhërohet zbritja e 1/3 së masës së dënimit. Vuajtja e dënimit fillon nga data e arrestimit në flagrancë, datë 18.06.2015. Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal urdhëron pezullimin e ekzekutimit të pjesës së pavuajtur të dënimit duke u vënë i pandehuri në provë për një periudhë kohore katër vjet. Në bazë të nenit 61 të Kodit Penal detyrohet i pandehuri Fatjon Rexho të marrë pëlqimin nga shërbimi i provës për ndryshimin e vendbanimit apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit Fatjon Rexho vetëm nëse ndaj tij nuk ka një masë tjetër sigurimi “Arrest në Burg” për ndonjë shkak tjetër apo vendim dënimi me burgim[...].”*

3. Ky vendim është kundërshtuar nga ana e shtetasit A.C., si dhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ku, kjo e fundit, ndër të tjera, ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 492, datë 20.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë lidhur me aplikimin e nenit 59 të KP-së për shtetasin F.P. dhe kërkuesin Fatjon Rexho, dhe dënimin e tyre me 7 (shtatë) vjet burgim.

4. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 720, datë 15.12.2016, ka vendosur: *“Lëniën në fuqi të vendimit gjyqësor penal Nr.492, datë 20.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me ndryshimin: Konform nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit për pjesën e mbetur të dënimit për të pandehurin A. C. për një periudhë 3 vjeçare. Urdhërohet lirimi i tij i menjëhershëm, në rast se nuk mbahet për ndonjë shkak tjetër ligjor. Urdhërohet i pandehuri A. C. të mbajë kontakt me Shërbimin e Provës.”*. Kjo gjykatë ka arsyetuar se vendimi gjyqësor nr. 492, datë 20.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendim i drejtë, i marrë në interpretim të drejtë të ligjit procedural e material dhe duhet të lihet në fuqi për të pandehurit F.P. dhe kërkuesin Fatjon Rexho.

5. Kundër vendimit të mësipërm, në datën 11.01.2017, ka paraqitur rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr.720, datë 15.12.2016 të Gjykatës së Apelit Vlorë, si dhe të vendimit nr.492, datë 20.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke mos aplikuar për asnjë prej të pandehurve nenin 59 të KP-së.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1384 (265), datë 18.10.2022, ka vendosur: *“Prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë nr. 720 të datës 15.12.2016 dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues”*, pasi Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka arsyetuar në lidhje me kushtet për zbatimin e dënimit alternativ të parashikuar nga neni 59 i KP-së dhe konkretisht për rrezikshmërinë e veprës penale.

7. Kërkuesi në datën 07.03.2023 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1384 (265), datë 18.10.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi gjyqësor i kundërshtuar i ka cenuar:

8.1. *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

8.1.1. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi rrjedha logjike e përdorur në vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk rezulton e qartë dhe e kuptueshme. Argumentet e pjesës arsyetuese nuk janë të lidhura logjikisht me atë të pjesës urdhëruese dhe nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, çka bën që përmbajtja dhe arsyetimi i tij të mos kenë një harmoni të brendshme. Është e paqartë se përse gjykata e apelit duhet të arsyetonte në lidhje me rrezikshmërinë e veprës penale si një nga kushtet e parashikuara nga neni 59 i KP-së, për aplikimin e dënimit alternativ, në një kohë që ajo ka verifikuar plotësimin e disa kushteve të tjera. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë pranon se kushtet e nenit 59 të KP-së nuk janë kumulative, por mjafton të ekzistojnë një ose disa nga këto kushte. Në këtë kuptim, vendimi krijon paqartësi dhe konfuzion si për kërkuesin, ashtu edhe për gjykatën më të ulët. Paqartësi konstatohen edhe në aspektin e

evidentimit të arsyes konkrete për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimit të çështjes për rishqyrtim, në kuptim të nenit 441 të Kodit të Procedurës Penale. Vendimi krijon premisën e mbivendosjes së dy dënimeve për të njëjtin fakt penal, përkatësisht dënimin alternativ të vuajtur dhe dënimin kryesor me burg, që ka zëvendësuar i pari.

8.2. *Kufizimin e lirisë të lidhur me parimin e proporcionalitetit*, të parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës, pasi vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka ashpërsuar pasojat e dënimit penal të dhënë për të njëjtën vepër penale, si dhe nuk ka gjetur një zgjidhje ligjore të konvertimit të dënimit alternativ në dënim kryesor. Duke revokuar dënimin alternativ të vuajtur plotësisht nga kërkuesi, në një kohë që e ka vlerësuar të drejtë masën e dënimit kryesor me burg, që ka zëvendësuar ky dënim alternativ, krijon premisën që gjykata e apelit, në procesin e rishqyrtimit të çështjes, të mos aplikojë dënimin alternativ dhe të vendosë që kërkuesi të vuajë dënimin me burg, përveç dënimit alternativ të vuajtur tashmë.

8.3. *Parimin e dënimit me ligj dhe parimin ne bis in idem*, të parashikuar nga neni 29 i Kushtetutës dhe neni 7 i KEDNJ-së, pasi vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë krijon efekte ekuivalente dhe materiale të një dënimi penal pa ligj. Me vendimmarrjen e tij, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e detyron gjykatën e apelit të japë dënim tjetër për kërkuesin dhe e detyron, gjithashtu, këtë të fundit të vuajë dy dënime penale për të njëjtën vepër penale, ndërkohë që aktualisht ai e ka përfunduar dënimin penal alternativ. Në rast të ndryshimit të vendimit nga Gjykata e Apelit Vlorë, kërkuesi do të vuajë plotësisht dy dënime penale (dënimin alternativ dhe dënimin kryesor), për të njëjtën vepër penale.

8.4. *Parimin e sigurisë juridike*, të parashikuar nga nenet 4 dhe 34 të Kushtetutës, ku ky i fundit e garanton individin dhe i jep atij sigurinë juridike që nuk mund të dënohet më shumë se 1 herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, por sipas mënyrës së parashikuar me ligj. Shkelja e këtij parimi kushtetues në procesin penal sjell dhunimin e parimit *ne bis in idem*. Kërkuesi e ka vuajtur plotësisht dënimin alternativ dhe është në gjendje të lirë që prej vitit 2020. Nëse në procesin e rishqyrtimit gjykata e apelit do të çmojë të veprojë sipas sugjerimit të Gjykatës së Lartë, duke mos aplikuar nenin 59 të KP-së, kërkuesi duhet të dënohet për së dyti për të njëjtën vepër penale.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Kolegji vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese (*shih vendimin nr. 12, datë 24.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron kjo Gjykatë, përfshirë

edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohej vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtijshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 4, datë 22.02.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuuesi i është drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e vendimin nr. 00-2022-1384 (265), datë 18.10.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur prishjen e vendimit nr. 720, datë 15.12.2016 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Në kërkesën drejtuar Gjykatës, kërkuuesi ka pretenduar se i ka shteruar mjetet juridike efektive dhe se gjykata e apelit është e detyruar t'i përmbahet vendimit të Gjykatës së Lartë, fakt që krijon premisë se kjo gjykatë, në procesin e rishqyrtimit të çështjes, të mos aplikojë dënimin alternativ dhe të vendosë që kërkuuesi të vuajë dënimin me burg, përveç dënimit alternativ të vuajtur tashmë.

15. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se vendimi i kundërshtuar, objekt i ankimit kushtetues individual, nuk ka vendosur në mënyrë përfundimtare për çështjen. Procesi gjyqësor për përcaktimin ose jo të fajësisë së kërkuarit vazhdon ende të gjykohej në themel nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në këto kushte, vendimi nr. 00-2022-1384 (265), datë 18.10.2022 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk mund të konsiderohet përfundimtar në kuptim të vendimit gjyqësor për të cilin janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive, sipas nenit 131, pika 1, shkronja "F", të Kushtetutës, pasi në të tilla raste ai i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike efektive për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë.

16. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.